

# PJESË NGA KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN NGA VJEDHJA

## 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kushtet e Përgjithshme të kontratës për Sigurimin nga Vjedhja, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit". Shoqëria e Sigurimeve "ANSIG" SH.A., këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Siguruesi".

Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i të cilit do të mbulohet sipas këtyre Kushteve të Sigurimit nga Vjedhja, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "I Siguruari".

"Kontrata për Sigurimin nga Vjedhja" e lidhur midis Siguruesit dhe të Siguarit, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Polica e Sigurimit".

## 2. OBJEKTI I SIGURIMIT

2.1. Siguruesi ofron Sigurimin nga Vjedhja për objektet e mëposhtme:

2.1.1. **paisje e sende shtëpiake** - bashkësia e mobiljeve, paisjeve e sendeve shtëpiake;

2.1.2. **makineri e pajisje** - pajisje, makineri, impiante të lëvizshme, veglat dhe pjesët ndërrimit e bazamentet përkatëse;

2.1.3. **pajisje zyre** - bashkësia e mobiljeve, makinave, veglave e orendive që përbëjnë pajisjet normale të një zyre, ose që i shërbëjnë përbushjes normale së një veprimtarie tregtare apo profesionale, impiantet e parandalimit të alarmit, kasafortat, raftet e sigurimit e të përforcuara, bloqet e kasetave të sigurimit (përjashtuar përmbajtjet përkatëse), përjashtuar sa treguar në përcaktimin e mallrave, sendeve me vlerë, objekteve të vlefshme e letrave me vlerë;

2.1.4. **mallra** - mallra, lëndë të para, prodhime gjysëm të gatshme, lëndë rezervë e materiale konsumi, ambalazhe të brendshme e të jashtme, përjashtuar sa treguar në përcaktimin e sendeve me vlerë, objekteve të vlefshme e letrave me vlerë;

2.1.5. **objekte të vlefshme** - kuadro pikturë, skulptura, objekte arti që nuk janë mobilje, peliçe, objekte argjendi, tapete e sikhade, përjashtuar sa treguar në përcaktimin e sendeve me vlerë e letra me vlerë;

2.1.6. **sende me vlerë** - gurë të çmuar, metale të vlefshme, objekte me metal të vlefshëm e perla;

2.1.7. **letra me vlerë** - kartmonedha, tituj krediti, obligacione e lloje të tjera të letrave me vlerë.

## 3. RREZIQET E SIGURIMIT

3.1. Siguruesi dëmshpërblen të Siguarin për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e objekteve të siguruar që rrjedhin nga vjedhja, si dhe veprimet në tentativa, gjatë kryerjes së saj si rrjedhojë e futjes në lokalim ose banesën e siguruar nëpërmjet:

3.1.1. dhunimit të mjeteve mbrojtëse të jashtme me anë të thyerjes, shqyerjes, përdorimit të çelësave levë ose veglave të tjera të ngjashme me to;

3.1.2. rrugëve jo të zakonshme, që kërkojnë kalimin e pengesave ose të mbrojtëseve duke përdorur mjete artificiale ose aftësi të veçanta vetjake;

## 4. RREZIQE TË PËRJASHTUARA

4.1. Sigurimi nga Vjedhja nuk mbulon dëmtimet apo humbjet që shkaktohen drejtpërdrejt apo indirekt prej:

4.1.1. shpërdorimit, përvetësimit, falsifikimit, mashtrimit, apo veprimeve të tjera të kryera me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë e të Siguarit, pjestarëve të familjes ose punonjësve të tij;

4.1.2. humbjeve të pashpjegueshme, zhdukjeve misterioze, mungesave në inventar, mungesave të shkaktuara nga gabimet kontabël ose në numërim gjatë inventarit;

4.1.3. vjedhjes së thjeshtë, vjedhjes nga klientët, vjedhjes me mashtrim, etj.;

4.1.4. përdorimit të dhunës fizike ose psikike për hedhjen në dorë të pasurisë së siguruar, përjashtuar tek rojet dhe në përputhje me kushtet e përmendura në nenet 4, 5 e 6;

4.1.5. manipulimit ose keqpërdorimit të pajisjeve elektronike të përpunimit të të dhënave; gjithashtu do të përjashtohen dëmet që rrjedhin nga dëmtimi i çdo lloj pajisjeje hardware e software;

4.1.6. zjarrit, eksplozionit ose çarjes së tubacioneve të ujit, edhe në se një gjë e tillë ndodh si rrjedhojë e vjedhjes;

4.1.7. tërmetit, stuhive, shpërthimeve vullkanike, përmblyetjeve, ndotjeve radioaktive e shpërthimit bërthamor;

4.1.8. veprimeve luftarake të çdo lloji pavarësisht nëse është shpallur lufta ose jo (përfshirë luftën civile), pushtimit ushtarak, gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, anarkisë, mosfunksionimit të shtetit (qoftë edhe në pjesë të caktuara të vendit), grushteve të shtetit, terrorizmit apo sabotimit të organizuar, revoltave, kryengritjeve, grevave, trazirave popullore, turbullirave civile, eksodeve, konfiskimeve, rekuizimeve, shkatërrimeve apo dëmtimeve të kryera me urdhër të çfarëdo lloj qeverie apo autoriteti shtetëror;

4.1.9. Siguruesi nuk mbulon dëme që shkaktohen e lehtësohen me qëllim e faj nga:

- persona që banojnë me të Siguarin dhe zënë lokalit ose banesën ku ndodhen sendet e siguruar ose lokalit e banesat me të cilat komunikojnë;

- vartësit e të Siguarit;

- të ngarkuarit me mbikqyrjen e sendeve të siguruar, lokalëve ose banesës ku ndodhen këto objekte.

## 5. VLERA DHE SHUMA E SIGURUAR

5.1. Shuma e siguruar, si rregull, do të jetë e barabartë me vlerën e sigurimit. Baza mbi të cilën do të përcaktohet shuma e siguruar do të vendoset në Policën e Sigurimit.

5.2. Për paisje e sende shtëpiake, makineri e pajisje, pajisje zyre, objekte e sende me vlerë:

5.2.1. Shuma e siguruar si rregull do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të tyre;

5.2.2. Në raste të veçanta kur një makineri ose grup makinerish ose pajisjesh nuk mund të përdoren më ose nuk janë të përdorshme për qëllimin e të Siguarit, shuma e siguruar do të jetë vlera e tregut.

5.3. Për mallrat, lëndë të para etj.

5.3.1. Shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën maksimale të tyre, e cila përfaqëson vlerën maksimale të mundshme të mallrave të depozituara, deklaruar me shkrim nga I Siguruari;

5.3.2. Në raste të veçanta, shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën mesatare të tyre, e cila përfaqëson vlerën mesatare që I Siguruari parashikon të ketë gjatë vitit, deklaruar me shkrim nga I Siguruari paraprakisht.

## 6. PRIMI I SIGURIMIT

6.1. Primi i sigurimit mund të paguhet tërësisht ose me këste, sipas këtyre rregullave:

6.1.1. Kur periudha e sigurimit është nën një vit, si rregull, primi i sigurimit do të paguhet njëherësh;

6.1.2. Kur periudha e sigurimit është 1 vit, si rregull, primi i sigurimit mund të paguhet me dy këste të barabarta;

6.1.3. Në rast të pagesës së primit të sigurimit me këste, shuma e primit do të shtohet në një përqindje të rënë dakort midis palëve, por jo më pak se 10 % e primit total të sigurimit.

## 7. PJESA E ZBRITSHME

7.1. Në rastet e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe/ose franshizë.

7.2. Vlera e pjesës së zbritshme dhe franshizës do të përcaktohen në Policën e Sigurimit.

## 8. POLICA E SIGURIMIT

Polica e Sigurimit lidhet në bazë të kërkesës me shkrim të të Siguarit. Siguruesi lëshon Policën e Sigurimit dhe përcakton primin e sigurimit në bazë të njoftimeve dhe deklarimeve të bëra nga I Siguruari. Kërkesat dhe njoftimet e deklarimet e tjera të të Siguarit i bashkëngjiten Policës së Sigurimit.

## 9. PERIUDDHA E SIGURIMIT

9.1. Periudha e sigurimit është një vit, përveç rasteve kur në Policën e Sigurimit përcaktohet ndryshe, por jo më pak se tre muaj, përjashtuar raste të tilla si ekspozita, panaire, etj.

## 10. DETYRIME

I Siguruari detyrohet:

10.1. Të zbatojë masat e rregullat e sigurimit teknik të përcaktuara në mënyrë specifike në Policën e Sigurimit, rregullat e rekomandimet e policisë si dhe të tregojë përkujdesjen e duhur për parandalimin e dëmit, psh. në rast të largimit të të Siguarit ose përsa kohë që puna në biznesin e tij është ndërprerë, mbylljen e dyerve - duke përfshirë dyert e kasafortave - dhe të gjitha hyrjet në objekt duhet të mbahen të mbyllura gjatë gjithë kohës;

10.2. Të regjistrojë mallin, sendet e letrat me vlerë dhe dokumenta të tjerë dhe t'i ruajë ato në kasafortë, përjashtuar në banesa;

10.3. Të ruajë dhe të mbajë plotësisht në punë të gjitha pajisjet e sigurimit që kanë ekzistuar në kohën që është bërë kërkesa për sigurim ose për të cilat është rënë dakort për t'u pasur më vonë - në veçanti sistemin e alarmit;

10.4. Të provojë dhe të kontrollojë këto paisje njëherë në vit duke i pasqyruar në p-v përkatës.

10.5. Të mbajë në kasafortë, në njësitë ekonomike, paratë, sendet, letrat me vlerë dhe dokumenta të tjera gjë që plotëson kërkesat e sigurisë të përshkruara nga Siguruesi.

## 11. NJOFTIMI I NGJARJES SË SIGURIMIT

Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, I Siguruari duhet:

11.1. Të njoftojë me shkrim Siguruesin menjëherë, të paktën brenda 24 orëve nga momenti që është venë në dijeni të ngjarjes, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe vlerën e përafërt të dëmit, si dhe të bëjë denoncimin përkatës pranë organeve kompetente;

11.2. Të paraqesë Siguruesit, brenda 3 ditëve nga ndodhja e ngjarjes, një listë të plotë e të specifikuar të sendeve të vjedhura apo të dëmtuara, me vlerat përkatëse, si dhe një kopje të denoncimit të kryer pranë organeve kompetente;

11.3. Të bllokojë librat e llogarisë dhe dëshmi të tjera të pasurisë së tij;

11.4. Të veprojë menjëherë për kthimin e sendeve të vjedhura dhe për ruajtjen e atyre të mbetura, edhe pse të dëmtuara.

11.5. Pas çdo denoncimi apo kërkesë për dëmshpërblim, pavarësisht nga vlera dhe fakti nëse dëmi është i dëmshpërbllyshëm ose jo, deri në ditën e 60-të nga data që dëmi është paguar ose përfunduar me një mënyrë tjetër, Siguruesi mund të zgjidhë Policën e Sigurimit duke paralajmëruar 30 ditë përpara të Siguarin.

## KËRKESA PËR DËMSPËRBLIM

12.1. I Siguruari, në rast të ndodhjes së dëmit, i paraqet Siguruesit kërkesën me shkrim për dëmshpërblim, sipas formularit të dhënë nga Siguruesi.

12.2. Siguruesi paguan ose refuzon pagimin e dëmshpërblimit brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim, duke dhënë me shkrim arsyet e refuzimit të dëmshpërblimit.

12.3. Siguruesi mund të pezullojë pagesën e dëmshpërblimit:

12.3.1. për aq kohë sa ekzistojnë dyshimet mbi të drejtën e të Siguarit për të marrë pagesën;

12.3.2. në qoftë se është filluar çështja penale lidhur me ngjarjen e sigurimit ndaj të Siguarit ose njërit prej përfaqësuesve të tij, deri në përfundimin e një procedure të tillë.

12.3.3. për aq kohë sa I Siguruari nuk paraqet dhe nuk plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi.

## 13. DËMSPËRBLIMI

13.1. Siguruesi përgjigjet për dëmet që vërtetohen gjatë periudhës së mbulimit në sigurim, por shuma e përgjithshme e dëmshpërblimeve nuk mund të jetë më e lartë se shuma e sigurimit e përcaktuar në Policën e Sigurimit.

## 14. MBISIGURIMI

14.1. Nëse shuma e sigurimit e tejkalon ndjeshëm vlerën e sigurimit, atëherë si Siguruesi ashtu edhe I Siguruari mund të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguruar, dhe primi i sigurimit do të pakësohet përkatësisht.

## 15. NËNSIGURIMI

15.1. Nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit shuma e siguruar është më e ulët se vlera e sigurimit, dëmshpërblimi i llogaritur do të shumëzohet me koeficientin e nënsigurimit.

15.2. Koeficienti i nënsigurimit përcaktohet si raport i shumës së siguruar ndaj vlerës së sigurimit.

## 16. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

16.1. Në rast se mosmarrëveshjet midis palëve nuk zgjidhen me mirëkuptim, atëherë do të zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lëshuar Polica e Sigurimit.